



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**

**Nr. 80, datë 6.7.2016**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË  
SIPAS SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” nenit 43, shkronja “c”, nenit 27, nenit 58, nenit 70 pika 1 dhe nenit 71 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 47 pika 4 dhe nenit 126 pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neneve 43 pika 3 dhe 62 pika 1 shkronja “c” dhe neni 72, pika 5 të ligjit nr.52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit të unifikuar të raportimit” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.45, datë 10.06.2009, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Në nenin 2, pika 3 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:  
“3. nenit 43 pika 3, nenit 62 pika 1 shkronja “c” dhe nenit 72, pika 5 të ligjit nr.52/2016 datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre””
  - b) Në nenin 2, pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:  
“6. neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar.”
  - c) Në nenin 3, pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

*“ERRS” - është sistemi elektronik raportues rregullator i cili, në zbatim të përgjegjësive ligjore të Bankës së Shqipërisë dhe kërkesave të kuadrit rregullativ mundëson raportimin “online” të SRU-së dhe të të dhënave të tjera, nga ana e subjekteve raportuese.”*

- d) Në nenin 5, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*“3. Formularët shoqërohen nga udhëzuesit dhe manualët përkatëse.”*
- e) Në nenin 6, pika 1, shkronja “d” togfjalëshi “*Departamenti i Statistikave*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Departamenti i Statistikave Financiare*”.
- f) Në nenin 9, pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:  
*“1. Të gjitha sistemet raportuese administrohen nga Zyra e Përpunimit të të Dhënave pranë Departamentit të Statistikave Financiare.”*
- g) Në nenin 9, pika 2 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:  
*“2. Procedurat e punës për administrimin dhe kontrollin e raportimeve përcaktohen me udhëzimet dhe manualët përkatëse, të cilat miratohen nga Administratori, i cili ka në varësi Departamentin e Statistikave Financiare.”*
- h) Në nenin 11 pas pikës 2 shtohet pika 2/1 dhe pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*“2/1. Raportimi në formë elektronike për subjektet raportuese banka bëhet përmes ERRS-së.”*  
*“6. Subjektet raportuese të cilat raportojnë përmes sistemit ERRS, dërgojnë me shkrim pranë njësisë pritëse, listën e punonjësve të autorizuar për plotësimin, kontrollin dhe dërgimin e raportimeve. Ndryshimet në listën e punonjësve të autorizuar për raportim duhet të njoftohen pranë njësisë pritëse pranë Bankës së Shqipërisë.”*
- i) Formularët 20-21, 24, 25, 34, 35, 36, 38/1, 31.1, 20/1, 46, 47, 33A, 33B, F1, F2, F3, F4 bashkëlidhur kësaj rregulloreje shfuqizohen dhe zëvendësohen me formularët F20-21, F37/4, F37/6, F37/5, F37/7, F37.9, F37.8, F37/3, F37/2, F37/1, F37, F34, F34.2, F35, F36.1, F36.2, F8.1, F8.2, F8.3, F8.4, F20\_21 Pkon\_Valutor, F61.2, F100/1, F60.1, F.33A, F.33B, F1, F2, F3, F4, bashkëlidhur këtij vendimi.
- j) Të miratojë formularët F22\_1, F28, F29, F31.1, F33B1, F33B3, F34.1 F35.2, F4.DM, F8.DM, F7.DM, F11.DM, F12.DM, MKR\_SA\_TDI, MKR\_SA\_EQU, F3.DM, F5.DM, F6.DM, F9.DM, F44, F45, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2016.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**